

VENDIM
Nr. 716, datë 26.8.2015

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME
TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS,
DHE SHOQËRISË “LORENZO” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË “DEPO
NR. 1, DEPO NR. 2 DHE DEPO NR. 3, TË AGJENCISË SË REZERVAVE TË
SHTETIT PLASË, KORÇË”, TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
REZERVAVE TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënëse dhe shoqërisë “Lorenzo”, sh.p.k., si qiramarrëse, për pasurinë “Depo nr. 1, Depo nr. 2 dhe Depo nr. 3, të Agjencisë së Rezervave të Shtetit Plasë, Korçë”, në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, me sipërfaqe të përgjithshme 8 699 (tetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², nga të cilat, sipas genplanit, sipërfaqe në objekt 2 200,92 (dy mijë e dyqind presje nëntëdhjetë e dy) m² dhe sipërfaqe funksionale 6 498,08 (gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë presje zero tetë) m².

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama